



Rockefeller
Brothers Fund
Philanthropy for an Interdependent World



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Fakte mbi #AktivitetinFilantropik 2020

| Përgatiti: **Maris Selamaj** dhe **Ana Zenelaj**

Vështrim i përgjithshëm

Viti **2020** ishte fatkeqësisht sërish një vit i vështirë për shkak të pandemisë globale Covid-19. Kjo situatë ndryshoi përgjithmonë mënyrën tonë të të jetuarit, na prezantoi me një realitet të ri dhe përsëri na rikujtoi rëndësinë e filantropisë, solidaritetit dhe ndihmës së ndërsjellë që mundësuam zbutjen e pasojave dhe ofrimin e një burimi mbështetjeje për të gjithë njerëzit e prekur drejtpërdrejtë apo tërthorazi.

Përmes një monitorimi të kujdesshëm ditor të dhurimeve, fushatave dhe eventeve të publikuara në media të ndryshme, media sociale, faqet e internetit të institucioneve publike dhe jopublike gjatë vitit 2020, u regjistrua një shumë dhurimi prej **103,688,004 Lekë (844,411 Euro)**.

Ky raport u bë i mundur falë mbështetjes financiare të Rockefeller Brothers Fund. Opinionet dhe pikëpamjet e autorëve nuk tregojnë ose pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Fondit.

Të gjitha të drejtat e rezervuara © **Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim**

Parathënie

Prej vitit 2011 Partnerët Shqipëri punon për promovimin e filantropisë në vend . Duke marrë në konsideratë informacionet e pakta në këtë fushë, **Partnerët Shqipëri** kreu studimet:

- **“Sipërmarrja dhe Filantropia”** për të krijuar një kuptim më të qartë të shkallës dhe natyrës së kauzave shoqërore të cilat mbështeten prej komunitetit të biznesit në Shqipëri,
- **“Një Vështrim Historik mbi Zhvillimin e Filantropisë në Shqipëri”**, që trajton këtë veprimtari, figurat kryesore dhe aktivitetin e tyre filantropik brenda dhe jashtë vendit, nga shekulli i XIX e deri në ditët e sotme,
- **“Aktiviteti Filantropik i Ndërmarrjeve në Shqipëri, Studimi i Dytë, 2016”** i cili synon të vlerësojë nivelin dhe karakteristikat e aktivitetit filantropik që kryen sektori i biznesit në Shqipëri, tiparet e zhvillimit të këtij aktiviteti gjatë periudhës 2011-2016, si dhe tendencat për të ardhmen.

Për të promovuar dhe mbështetur zhvillimin e kësaj traditë të hershme dhe me vlera, Partnerët Shqipëri ka organizuar prej gjashtë vitesh ceremoninë **“Cmimi i Filantropisë”**, duke shprehur mirënjohjen dhe falenderimin për individët, familjet dhe bizneset që kontribuojnë për përmirësimin e cilësisë së jetës në vend. Vlerësimi dhe stimulimi i një aktiviteti të tillë mbetet i rëndësishëm për dimensionin human dhe ekonomik që ai mbart.

Sektori i biznesit luan, midis aktorëve të tjerë, një rol të rëndësishëm në mbështetjen e iniciativave që adresojnë probleme të mprehta sociale, ekonomike dhe mjedisore. Në këtë funksion, Partnerët Shqipëri ka vendosur një partneritet të ngushtë me sektorin e biznesit në mbështetje të bizneseve të reja sociale në fushën e industrisë së gjelbërt.

Prej vitit 2012 Partnerët Shqipëri organizon **“Konkursin e Bizneseve të Gjelbra”**, i cili ofron mbështetje për start-upet, iniciativa të reja të gjelbra që përdorin burime lokale dhe rivitalizimin e traditave të prodhimit dhe tregjeve lokale. Financimi mbështetës është një kombinim i institucioneve filantropike dhe kontributeve nga biznesi. Tre idetë më të mira fituese konkurojnë në nivel rajonal në **"Konkursin Ballkanik të Bizneseve të Gjelbërta"** që organizohet nga Balkan Green Foundation.

Prej vitit 2019, Partnerët Shqipëri organizon eventin **“Rrathë Dhurues”**, një ankand dhurimi live, i cili mbledh së bashku individë nga fusha të ndryshme duke vënë në dispozicion ekspertizën, kohën dhe burimet financiare për të mbështetur projekte/kauza konkrete që sjellin ndryshime sociale në komunitete të caktuara. Përmes këtij eventi mundësohet mbështetja e 3 nismave konkrete komunitare dhe shuma minimale e synuar për secilën initiative është 300,000 lekë.

Metodologjia

Ky raport pasqyron aktivitetin filantropik në Shqipëri gjatë vitit 2020 i sjellë në mënyrë të sintetizuar nga Partnerët Shqipëri, bazuar në monitorimin ditor dhe **raportimin e rregullt mujor**.

Metodologjia e përdorur për realizimin e tij u bazua në të dhëna të mbledhura nga hulumtimi ditor i mediave, përfshi ato sociale si dhe nga institucionet publike dhe jo-publike gjatë periudhës **janar - dhjetor 2020**.

Raporti analizon sektorët dhe çështjet kryesore që janë mbështetur, natyrën dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik si dhe natyrën e dhuruesve dhe përfituesve.

Nëpërmjet këtij monitorimi, Partnerët Shqipëri synon të rrisë vetëdijen publike mbi aktivitetin filantropik dhe të informojë të gjithë aktorët e përfshirë dhe të interesuar mbi impaktin dhe vlerën sociale të tij.

Terminologjia

Dhurim i drejtpërdrejtë - Dhurimi që kryhet direkt nga dhuruesi tek përfituesi

Fushatë për ngritjen e fondeve - Mbledhje e fondeve që ndodh gjatë një periudhe të caktuar kohe për një kauzë të caktuar sociale

Event - Është një ngjarje që organizohet në kuadër të mbledhjes së fondeve për një kauzë të caktuar

Zbutje e varfërisë - Dhurimet që janë kryer për zbutjen e varfërisë për individë apo familje që jetojnë në vështirësi ekonomike apo të prekur nga fatkeqësitë e mëparshme natyrore

Dhurime sezonale – Dhurime që kryen gjatë sezonit të festave

Publik i gjerë - Grupe njerëzish apo individë, të cilët janë ndihmuar nëpërmjet ndihmave ekonomike apo materiale në raste të fatkeqësive natyrore, apo vështirësive të jetesës

Grup dhuruesish - Grupe të mëdha ose të vogla individësh që dhurojnë

PAK - Personat me aftësi të kufizuara

Miks – Dhurime të cilat kombinohen nga më shumë se një kategori / qytet

NVM - Ndërmarrje të vogla dhe të mesme

OJF - Organizata jofitimprurëse


Platforma Crowdfunding (Individë apo familje) – dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga individë apo familje

Platforma Crowdfunding (OJF) – dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga OJF-të

Numri i Dhurimeve

Në vitin 2020 u identifikuan **432** dhurime të raportuara në total, nga të cilat **104** (24%) ishin në përgjigje të pandemisë Covid-19 dhe pasojave të tërmetit të vitit 2019.


Për sa i përket natyrës së dhurimeve, **351** (81%) ishin në para, **56** (13%) në mallra/produkte, **16** (4%) në shërbime profesionale dhe **9** (2%) në forma të tjera dhurimi.



Vlera sipas natyrës së dhurimit në Lekë

103,688,004 Lekë (844,411 Euro) është vlera totale e dhurimeve të identifikuara në nivel kombëtar për vitin 2020. Këto dhurime u kryen në para, mallra/produkte dhe miks. Dhurimi në para vazhdon të mbetet forma më e preferuar me 93% të vëllimit të përgjithshëm të dhurimeve.


Rreth 26,617,299 Lekë (215,670 Euro) u mblodhën përmes fushatave dhe eventeve të organizuara në përgjigje të situatës pandemike Covid-19 dhe pasojave të tërmetit të vitit 2019.




Forma e Dhurimit

Fushatat për ngritjen e fondeve ishin forma e preferuar e dhurimit me një total prej **239** (55%) raste, ndjekur nga *dhurime të drejtpërdrejta* me **163** (38%) dhe *evente* me **30** (7%) raste.

Dhurime në grup



Dhurime individuale




Evente
30

432


Dhurime të drejtpërdrejta
163

Fushata për ngritjen e fondeve
239


Dhurime në grup




Dhurime individuale






Dhurime në grup



Dhurime individuale




Dhuresit sipas formës së dhurimit




*Dhuresit llogariten vetëm një herë, pavarësisht nga numri i dhurimeve të kryera në secilën prej kategorive të "Formës së dhurimit".

Fushatat për ngritjen e fondeve



*Platforma e dedikuar e Facebook për ngritje fondesh për kauza sociale.


Evente



Vlera sipas natyrës së dhuruesit

Viti 2020, si një vit i vështirë pati një numër të konsiderueshëm të fushatave për ngritjen e fondeve, si pasojë dhuruesit me vlerën më të lartë ishin “grup dhuruesish” me një vlerë totale prej **41,264,349 Lekë** (336,047 Euro).


Ndërkohë që **28,523,995 Lekë** (232,293 Euro) u dhuruan nga *Korporatat*, ndjekur nga dhurues *Miks* me **26,065,387 Lekë** (212,270 Euro) dhurues *Individ* me **6,065,313 Lekë** (49,394 Euro), *OJF-të* me **1,574,066 Lekë** (12,819 Euro) dhe lloje të tjerë dhuruesish me një total prej **194,894 Lekë** (1,587 Euro).



Numri i dhuruesve*

Sa i përket numrit të dhuruesve, “grup dhuruesish” renditet i pari me **120** dhurues unik. Kjo kategori dhuroi rreth 40% të vlerës totale.

Dhuruesit e tjerë që kanë kontribuar më së shumti ishin *Korporata* me **67** dhurues unik, të ndjekur nga *Individ* me **47** dhurues unik, *Miks* me **34** dhurues unik dhe kategori të tjera të dhuruesve me **63** dhurues unik gjithsej.



*Në kuadër të kësaj analize, dhuruesit llogariten vetëm një herë, pavarësisht nga numri i dhurimeve të kryera gjatë procesit të monitorimit.

#1 Banka Amerikane e Investimeve

#2 Banka Credins

#3 Grupi Balfin

#4 Raiffeisen Bank Shqipëri

#5 Fondacioni "Shpresë për Botën"

Dhuruesit kryesor sipas numrit të dhurimeve

#1 Miks - 13,012,650 Lekë

Fushata për ngritjen e fondeve "Për Reinaldin", i cili vuante nga leuçemia

#2 Sigal Uniq Group - 7,429,200 Lekë

Dhurimi i një aparati portativ radiologjik për Spitalin "Shefqet Ndroqi"


#3 Miks - 6,202,500 Lekë

Fushata për ngritjen e fondeve "Për Tuanën", e cila vuante nga një formë e rrallë e anemisë

Dhuruesit kryesor sipas vlerës së dhurimeve


Përfituesit

Përfituesit kryesorë për vitin 2020, ishin *Publiku i Gjerë* me **202** (47%) të totalit të rasteve të dhurimit, ndjekur nga *Fëmijët dhe të Rinjtë* me **180** (42%), *Të Rriturit* me **44** (10%) dhe *Të Tjerë* me **6** (1%) të totalit të rasteve të dhurimit.



Publik i gjerë

- Vështirësi Ekonomike (54.46%)
- Publik i Gjerë (13.86%)
- Komunitete Minoritare (0.99%)
- Zonë Speci ke (30.69%)




Fëmijë dhe të rinjtë

- Me aftësi të ku zuar (45%)
- Pa Përkujdesje Prindërore (40.56%)
- Zonë Gjeogra ke Speci ke (7.78%)
- Fëmijë dhe të rinjtë (5%)
- Vështirësi Ekonomike (1.11%)
- Komunitete Minoritare (0.56%)




Të rritur

- Viktima të dhunës dhe tra kimit (40.91%)
- Me aftësi të ku zuar (27.27%)
- Të rritur (22.73%)
- Prindër të vetëm (6.82%)
- Të pastrehë (2.27%)



Të tjerë

- Miks (83.33%)
- Mbrojtja e kafshëve (16.67%)




Shpërndarja gjeografike e dhurimeve

Përfituesit

Gjatë vitit 2020, pati dhurime nga pothuajse çdo qytet i Shqipërisë, e megjithatë për të gjashtin vit radhazi **Tirana** renditet e para me 46,3% të përfituesëve në nivel kombëtar.

Impakti i numrit të madh të fushatave lokale dhe kombëtare gjatë vitit 2020, ka dhënë rezultat edhe tek përfituesit, ku në vend të dytë renditen përfituesit miks me 17,1% dhe në vend të tretë përfituesit në nivel kombëtar me 6,3%.





Dhuresit

Për vitin 2020, shumica e dhuruesve ishin nga qyteti i **Tiranës** (51,4%), ndjekur nga Durrësi (1,9%) dhe Elbasani (1,6%).

Dhuruesit nga diaspora të identifikuar nga ky monitorim përbëjnë 2,3% të dhuruesve, dhe vijnë nga vende si **Zvicra, Britania e Madhe, Gjermania, SHBA, Suedia etj.**

Gjithashtu, një numër i madh i dhuruesve janë nga zona të pa specifikuara, kështu që dhuruesit e panjohur u renditën në vendin e dytë me 32,9%.




Qëllimi i Dhurimit

Tre fushat kryesore të dhurimit mbeten të njejtat si vitin e kaluar

#1 Përgjigje ndaj fatkeqësisë natyrore

#2 Mbështetje për grupeve e marginalizuara

#3 Zbutje e varfërisë



■ Përgjigje ndaj fatkeqësisë natyrore ■ Mbështetje e grupeve të marginalizuara ■ Zbutja e varfërisë ■ Dhurime sezonale ■ Shëndetësi
■ Art dhe kulturë ■ Edukim ■ Sipërmarrje Sociale ■ Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit ■ Sport ■ Mbrojtja e kafshëve ■ Shkencë

Kanalet e dhurimit

Monitorimi ka treguar që gjatë vitit 2020, dhuruesit kanë preferuar ta përçojnë vetë dhurimin tek përfituesi, ndaj *Dhurimi i drejtpërdrejtë* ishte kanali kryesor me **163** (38%) të rasteve, ndjekur nga *OJF-të* me **148** raste (34%), ndërsa **45** raste (10%) të dhurimeve u kanalizuan përmes *Platformave Crowdfunding të organizuara nga OJF-të*.




■ Dhurim i drejtpërdrejtë ■ OJF ■ Platforma Crowdfunding (OJF) ■ Media Vizive ■ Institucione Private ■ Institucione Sociale
■ Qeveria Qendrore/Vendore ■ Platforma Crowdfunding (Individë apo familje)

Shpërndarja e dhurimeve mbi baza mujore


Përsa i përket dhurimeve gjatë vitit 2020, muajt me numrin më të lartë të dhurimeve janë **prilli**, **tetori** dhe **dhjetori**. Këto dhurime janë rrjedhojë e situatës pandemike dhe fushatave sensibilizuese në kuadër të sindromës Doën, kancerit të gjirit, etj.

Duke iu referuar vlerës së dhurimeve, tre muajt e fundit kanë shënuar vlerën më të lartë të dhurimit. Këto dhurime lidhen me dhurimet sezonale dhe disa fushata sensibilizuese.

Vlera



Numri





Evente & Fushata



Fushata e World Vision Albania

Gjatë karantinës në Shqipëri, shumë familje në nevojë u përballën me vështirësi në plotësimin e nevojave themelore si ushqimi dhe të tjera furnizime të nevojshme.

Por falë World Vision Albania, 2,705 familje në Dibër, Durrës, Elbasan, Kamëz, Korçë, Kurbin, Lezhë, Librazhd, Maliq, Mirditë, Prrenjas, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë u furnizuan me ushqime dhe paketa higjieno-sanitare. Ndërkohë, 54 familje u mbështetën me pajisje dhe produkte bujqësore.

Procesi i shpërndarjes u koordinua me autoritetet vendore dhe u menaxhua në bashkëpunim të ngushtë me stafin e bashkive përkatëse, për t'u ardhur në ndihmë këtyre familjeve në nevojë.

Burimi: [Facebook](#)



Fushata “Red for Kids”

Fushata “Red for Kids”, e nisur nga Fondacioni “Vodafone Albania” po vijon misionin për t'u mundësuar fëmijëve të familjeve në nevojë në të gjithë Shqipërinë edhe më shumë akses në sistemin e mësimin online. Gjatë muajit tetor 2020, Fondacioni Vodafone organizoi në ambientet e shkollës 9-vjeçare “Kus”, Kashar, Tiranë eventin “Digjitalizim, për më shumë akses në arsim”, ku u prezantua dhurimi i 10,000 pajisjeve të tjera smart me qëllimin që askush të mos mbetet pas në procesin mësimor. Deri më tani Vodafone nëpërmjet #RedforKids ka kontribuar në 15,000 pajisje smart, një dhurim ky, nga më të rëndësishmit për sistemin arsimor në këto kohë të vështira për vendin. Të pranishëm në këtë event ishin Ministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë Znj. Evis Kushi, Drejtori i Përgjithshëm i Vodafone Albania, Z. Achilleas Kanaris dhe Drejtoresha e AKSH-it, Znj. Mirlinda Karçanaj, si përfaqësues e mbështetës të këtij procesi digjitalizimi në sistemin arsimor në Shqipëri. Drejtori i Përgjithshëm i Vodafone Albania, Z. Achilleas Kanaris u shpreh se nisma ofron mundësi të barabarta qasjeje në edukim dhe informacion.

Burimi: [Vodafone.com](#)



Për 100 vajza dhe djem!

Fondacioni Tim Tebow mbështeti më shumë se 100 vajza dhe djem të Qendrës Xhontatan! Mbështetja e tyre siguroi ofrimin e shërbimeve terapeutike falas për këta të rinj me nevoja të veçanta deri në fund të dhjetorit 2020.

Burimi: [Facebook](#)

Pandemia e Covid-19

Situata emergjente e Covid-19 solli një seri pasigurish për shoqërinë shqiptare. Për më tepër, vendi në muajt e parë të vitit 2020 ishte ende duke u rimëkëmbur nga tërmeti shkatërrues i nëntorit 2019. Këto fatkeqësi natyrore ndikuan në shëndetin, ekonominë, jetën sociale dhe dimensionet e tjera të shoqërisë shqiptare. Efektet ishin të dukshme dhe shkatërruese sidomos tek njerëzit më në nevojë. Nga ana tjetër, bota u bashkua si kurrë më parë për të luftuar pandeminë COVID-19, pasi qeveria, punonjësit shëndetësorë, forcat e policisë dhe ushtrisë, bizneset dhe shoqëria civile punuan së bashku për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve. Të njëjtat efekte u ndjenë edhe në Shqipëri ku solidariteti dhe bashkëpunimi lehtësuan pasojat e pandemisë. Fryma e solidaritetit nuk u manifestua vetëm brenda vendit, por edhe në vendet e tjera fqinje.

Që nga fillimi i krizës pandemike, Shqipëria dërgoi dy ekipe mjekësore në Itali. Këto gjeste u përshëndetën nga fqinjët tanë italianë dhe nga vetë Ministri i Jashtëm Di Mario. Gjithashtu nisma të ndryshme u ndërmorrën për të mbështetur sektorët në vijën e parë të rrezikut. Ndër rastet e shumta mund të përmendim: profesorët dhe studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës printuan maska 3D në ndihmë të stafit mjekësor, Banka Amerikane e Investimeve dhuroi tre pajisje respiratore për terapi intensive, dy teknikë laboratorësh dentarë arritën të prodhojnë përmes një printeri 3D një pajisje përshtatëse, e cila mundëson dyfishimin e kapacitetit të respiratorëve, arkitektët Dea Buza dhe Albano Guma, prodhuan maska mbrojtëse për stafin mjekësor të QSUT dhe Spitalin e Shkodrës me printerë 3D, me shpenzimet e tyre. Përdorimi i mjeteve të TIK-ut mbështeti nisma si platforma online "Heroin" e cila krijoi një rrjet vullnetarësh, fushata online të ngritjes së fondeve "Covid-19: Ndiemoni spitalin shqiptar të blejë respirator", etj.

Një rol të rëndësishëm luajtën dhe organizatat e shoqërisë civile. Ato kanë qenë të angazhuara në menaxhimin dhe përballimin e situatës që nga fillimi. OShC-të kanë qenë pranë njerëzve në nevojë, duke shpërndarë mijëra pako ushqimore për familjet në nevojë ekonomike në të gjithë Shqipërinë, në koordinimin me Ministrinë e Mbrojtjes dhe autoritetet vendore. Kryqi i Kuq Shqiptar gjithashtu ofroi ndihmë për njerëzit në nevojë dhe për profesionistët që ende po luftojnë me pandeminë.

Shqiptarët që jetojnë jashtë territorit të Shqipërisë kanë treguar një bujari dhe solidaritet të spikatur në vendet e tyre për tejkalimin e kësaj situatë. "Milan for Albania" ishte një nga nismat e ndërmarra dhe të frymëzuara nga Dr. Altin Palloshi. Kjo platformë ofroi këshilla, rekomandime, informacion dhe konsulta për popullatën shqiptare. Shumë fushata të ngritjes së fondeve u organizuan nga shqiptarët në SH.B.A. dhe Mbretërinë e Bashkuar, gjithashtu pako ushqimore dhe furnizime të tjera u dërguan tek ata që ishin në nevojë urgjente.


Sektori i telekomunikacionit erdhi në ndihmë të sistemit arsimor. Sistemi i mësimit online përfitoi shumë nga fushata të tilla si "Red for Kids" nga Vodafone Albania, "SchoolMe" nga Altelecom Albania apo aksesit falas në platformën arsimore "RTSH Shkollë" nga One Telecommunications.





Krahasimi ndërmjet 2019 - 2020


Numri i dhurimeve




Sikundër viti 2019, 2020-ta ishte një vit në të cilin njerëzit treguan një solidaritet të madh në përballimin e situatës pandemike të shkaktuar nga Covid-19. Duke e krahasuar me vitin e kaluar, kemi identifikuar një ulje të vogël të numrit të dhurimeve nga **499 në 2019 në 432 në 2020**.

Gjatë vitit 2020, shumica e dhurimeve u kryen në forma të kontributit në natyrë që erdhën si përgjigje e menjëhershme ndaj situatës pandemike. Fushatat e ndërgjegjësimit, dhurimet individuale dhe dhurimet e aksesorëve apo pajisjeve mjekësore në luftën kundër Covid-19 përbëjnë një pjesë të madhe të dhurimeve. Sfidat e vështira ekonomike dhe sociale si dhe kontributi në natyrë, ndikoi në vlerën e dhurimeve në krahasim me vitin 2019.

Vlera e dhurimeve




Tre dhuruesit kryesorë



Në vitin 2020 “grup dhuruesish” u rendit i pari me një numër të përgjithshëm prej 120 dhuruesish unik, që është gati 50% më shumë se dhuruesi kryesor unik të identifikuar në 2019.

Siç përshkruhet në raport, grupi i sipërpërmendur i dhuruesve, erdhi si rezultat i fushatave për ngritjen e fondeve, eventeve dhe kontributeve në natyrë, ndërsa në vitin 2019 “dhuruesit miks” ishin kryesorët si rezultat i fushatave masive për ngritjen e fondeve dhe mobilizimit të paprecedent që bëri bashkë lloje të ndryshme dhuruesish.

Lidhur me qëllimin e dhurimit, tre fushat kryesore mbeten të njëjta për dy vite rresht, specifikisht: *Mbështetja e grupeve të marginalizuara, përgjigje ndaj fatkeqësisë natyrore dhe zbutja e varfërisë.*





Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate, kati 10,
App. 71 / 73, PO BOX 2418/1
1010 Tirana, Albania